



**DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PUNËVE PUBLIKE
DREJTORIA E TRANSPORTIT E TRAFIKUT RRUGOR**

KOMPLETIMI I NËNSISTEMIT TË QENDRËS SË KONTROLLIT TË TRAFIKUT ME KAMERA TELEVIZIVE ME QARK TË MBYLLUR DHE INTEGRIMI I TIJ ME NËNSISTEMET E TJERA TË QENDRËS

RELACION TEKNIK

2018

PËRMBAJTJA

PËRMBAJTJA.....	2
1. HYRJE.....	3
2. GJENDJA EKZISTUESE	3
3. PROJEKTI I PROPOZUAR.....	5
4. AFATI PËR REALIZIMIN E PUNIMEVE.....	6
5. KONKLUZIONE	6

Lista e Figurave

Figura 1 Harta e kamerave ekzistuese.....	4
Figura 2 Harta e kamerave ekzistuese dhe të propozuara	6

1. HYRJJE

Tirana është qyteti me popullsinë më të lartë, ku pjesa me e madhe e popullsisë së vendit është e përqëndruar tashmë në të. Për shkak të zhvillimit të shpejtë dhe rritjes të menjëhershme të saj në dy dekadat e fundit, Tirana po përjeton probleme të trafikut të rënduar. Këto probleme ndihen më së shumti gjatë orëve pik të ditëve të javës, kryesisht gjatë vitit shkollor. Aktualisht në Tiranë operon Qendra e Monitorimit e Menaxhimit të Sistemeve të Trafikut (MMST), e cila përmban sistemet inteligjente të transportit, që kanë për qëllim shërbimet inovative të lidhura me mënyra të ndryshme të transportit dhe menaxhimit të trafikut, si dhe për t'i mundësuar përdoruesve të ndryshëm të jenë më të informuar, më të sigurtë, më të koordinuar dhe më të "zgjuar" për të përdorur rrjetin e transportit. Kjo Qender monitoron dhe menaxhon në kohë reale këto sisteme:

- Rreti semaforik
- Tabelat me mesazhe të ndryshueshme
- Rrjeti i kamerave televizive me qark të mbyllur

Në Tiranë janë instaluar 23 kamera me qark të mbyllur, të cilat monitorojnë kryqëzimet kryesore të saj, por ky numër nuk është i mjaftueshëm për një motirotimin të plotë të trafikut në qytet. Për këtë arsye lind nevoja e instalimit të disa kamerava të tjera shtesë, të cilat do të ndihmojnë në përmirësimin e fluksit të trafikut. Qëllimi është përmirësimi i menaxhimit të fluksit të trafikut, duke reduktuar kohën e pritjes në kryqëzime, uljen e sasisë së ndotjes nga gazet e daljes, kryesisht gjatë oreve pik të ditës, etj. Ky projekt është në kuader të projektit të Bashkisë "Tirana Smart City".

2. GJENDJA EKZISTUESE

Në Figurën 1 është paraqitur harta e qytetit me vendndodhjet e kamerave ekzistuese të vendosura në rrugët hyrëse dhe dalëse të Tiranës.




Figura 1 Harta e kamerave ekzistuese

Disa nga problematikat që vihen re gjatë punës së menaxhimit të trafikut janë si më poshtë vijon:

- Mungesa e monitorimit të plotë të trafikut në kryqëzimet apo rrugët e qytetit
- Menaxhim lokal i fluksit të trafikut vetëm në ato kryqëzime ku janë instaluar kamerat, duke zhvendosur trafikun e rënduar në kryqëzimet e tjera të pamonitoruara me kamera
- Informacion viziv mbi fluksin e trafikut i kufizuar për përdoruesit e ndryshëm në aplikacionin TiranaIme

Pamjet e kamerave janë të publikuara në kohë reale në aplikacionin TiranaIme, imazhet e të cilave përditësohen çdo 30 sekonda automatikisht dhe u shërbejnë përdoruesve të ndryshëm të marrin informacion në lidhje me situatën e trafikut në qytet.

Duke parë gjendjen ekzistuese dhe pamjaftueshmërinë e kamerave për të menaxhuar trafikun në qytet, Bashkia Tiranë ka parashikuar në projektbuxhetin 2018-2020 implementimin e këtij projekti.

3. PROJEKTI I PROPOZUAR

Projekti propozon instalimin e 51 kamerave shtese në 44 kryqëzime, integrimin e tyre me nënsistemet e tjera ekzistuese të qendrës, duke plotësuar kështu një tablo të qartë të qytetit për operatorët e MMST për përmirësimin e menaxhimit të trafikut si dhe monitormin në kohë reale nga ana e përdoruesve nëpërmjet aplikacionit TiranaIme. Secila kamerë do të ketë një IP unike dhe do të lidhet me serverin me anën e fibrave optike, i cili është rrjeti primar i komunikimit dhe nëpërmjet Router-it 3G, rrjeti sekondar. Sëitch-i i fibrës optike dhe Router 3G, në të gjitha nyjet do të konfigurohen me IP përkatëse në mënyrë që të realizohet komunikimi i vazhdueshëm dhe i sigurtë i kamerave me serverin dhe anasjelltas. Në dhomën e serverave do të instalohet edhe një server i administrimit të imazheve, i cili do të jetë i integruar me serverin ekzistues. Gjithashtu, do të instalohen edhe 36 UPS të rinj, në ato nyje ku nuk ka një të tillë, të cilat shërbejnë për vazhdimësinë e funksionimit të kamerave në rastet e ndërprerjes apo luhatjeve të energjisë elektrike.

Punimet që do të kryhen për implementimin e projektit janë:

1. Punime në rrugë

Duke u nisur nga përlllogaritjet analitike në terren sipas profilit të rrugëve rezulton se duhet të kryhen disa punime si:

- Skarifikim asfalti
- Germim dheu dhe kanalesh
- Punime shtresash: çakel, binder, stabilizant, etj.

2. Punime në trotuar

Gjatë studimit në terren është parë e nevojshme prishja e shtresave dhe trotuareve (pallaka dhe bordura betoni), të cilët do të zëvendësohen rishtas. Punimet janë si më poshtë:

- Prishje të pllakave dhe bordurave të betonit
- Betonim i bazamentit të centralit, në rastet e kryqëzimeve ku aktualisht nuk ka, i cili shërben për instalimin e pajisjeve
- Betonim shtyllë, në rastet kur nuk ka një shtyllë të përshtatshme brenda parametrave të kërkuara që kërkon instalimi i kamerës.

3. Punime ndriçimi dhe sinjalizimi

Në projekt është përlllogaritur hapja e pusetave të kontrollit, si dhe lidhja e centralit me fiber optike. Në punimet e ndriçimit përfshihen:

- Përcjellës PPV, Φ (3Gx2.5mm²)
- Kabëll netëorku UTP Cat. 5e
- Kabëll i fibrës optike, 8 fije në tub Φ 25mm
- Aksesorët për lidhjen me fibren optike
- Centrali

Në projekt janë përfshirë dhe punimet e montimit të kamerave dhe punimet e shërbimit, të cilët do të sigurojnë integrimin e tyre me sistemin aktual të serverit.

Në Figurën 2 është paraqitur harta e qytetit me vendndodhjet e kamerave ekzistuese dhe të propozuara në qytetin e Tiranës.




Figura 2 Harta e kamerave ekzistuese dhe të propozuara

4. AFATI PËR REALIZIMIN E PUNIMEVE

Punimet për zbatimin e projektit “Kompletimi i nënsistemit të qendrës së kontrollit të trafikut me kamera televizive me qark të mbyllur dhe integrimi i tij me nënsistemet e tjera të qendrës” është menduar të realizohet në harkun kohor të 6 muajve kalendarik.

5. KONKLUZIONE

Projekti i propozuar konsiston në instalimin e 51 kamerave si dhe integrimin e tyre me sistemet ekzistuese.

Realizimi i këtij projekti i shërben të gjithë përdoruesve të ndryshëm të rrugës në qytetin e Tiranës duke krijuar lehtësira në levizjen e tyre si dhe përmiresimin e cilësisë së jetës së qytetarëve.